



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:104924

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05635568

A.nr.1212/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, në konfliktin administrativ të paditësit, F.K. nga ..., me adresë në rrugën të cilin sipas autorizimit bartës e përfaqëson avokate ... nga kundër të paditurave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdyl Bekteshi, me bazë juridike: anulim vendimi, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarës së palës paditëse, palës së paditur KPMSHCK, dhe në mungesë të palës së paditur MTI, me datë.12.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit ... nga ..., ka kërkuar që të aprohet si e bazuar kërkesëpadia e tij dhe të anulohen si të kundërligjshme vendimet e të paditurave Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë me nunër protokollit 8744 i datës 25.11.2020 dhe vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.151/2021 i datës 28.04.2021, ashtu që të detyrohet e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës dhe të obligohet e njëjta që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 19.179,73 euro në emër të pagave për periudhën nga viti 2020,2021,2022,2023 dhe janar të viti 2024, me kamatë ligjore prej 8%, **si e pa bazuar**.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi A.nr.151/2021 i datës 28.04.2021 i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK)
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, mbajtur në prani të autorizuarës së paditësit, të autorizuarit të të paditurit KPMSHCK dhe Ekspertit Financiar ... dhe në mungesë të paditurës MTI, respektivisht Avokaturës Shtetërore e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: flet-kthesa e dt. 05.03.2024).

Paditësi ... me padinë e datës 28.05.2021, si dhe me parashtrësën për precizimin e padisë të datës 15.12.2023 dhe në seancat gjyqësore, respektivisht në shqyrtimin kryesor të datës 12.04.2024 përmes të autorizuarve të tij, ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadia e tij të aprovet si e bazuar dhe të anulohen si të kundërligjshme vendimet e të paditurave Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë me numër protokolli 8744 i datës 25.11.2020 dhe vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.151/2021 i datës 28.04.2021, ashtu që të detyrohet e paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm me të gjitha të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës dhe të obligohet e njëjta që paditësit t'ia kompensoj pagat sipas vendimit mbi emrim në vendin e tij të punës sipas koeficientit 7, me kamatë ligjore prej 8% prej momentit të shkëputjes nga marrëdhënia e punës e deri në kthimin në punë. Ka kërkuar të obligohet e paditura MTI që t'ia kompensojë paditësit shumën prej 19.179.73 Euro, si në Ekspertizën Financiare, ashtu që ti kompensojë të gjitha pagat e vitit 2020 deri në vitin 2023 dhe muajin e parë të vitit 2024 me të gjitha kontributet dhe me kamatë ligjore 8%. E autorizuarja e paditësit ka deklaruar se paditësi në atë kohë ka qenë në spital i sëmurë me COVID 19 dhe ka kërkuar që të ndërpritet çdo punë në lidhje me auditimin, pasi që nuk ka mundur të jetë prezent, mirëpo kjo nuk është marrë parasysh nga Ministria dhe pavarësisht se paditësi e ka shpjeguar vendin se ku gjenden dosjet, pretendimet e tyre kanë qenë se nuk kanë mundur ti gjejnë dhe nuk dihet nëse ato dosje janë gjetur apo jo në zyrën e tij. Pretendimet e paditësit kanë qenë se ato dosje kanë qenë në dollapin e tij, në zyrën e tij dhe konsideron se është dashur që ti jepet një vërejtje me gojë apo me shkrim, për të arritur deri tek vendimi i tillë nga ana e Ministrisë. E njëjta pretendon se asnjëherë nuk është ngritur ndonjë vepër penale për paditësin. E njëjta shton se vendimi i Ministrisë duhet anuluar për faktin se nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se marrja e dokumenteve siç pretendon e paditura është bërë nga paditësi.

I autorizuari i të paditurit KPMSHCK në përgjigjen në padi të datës 04.10.2022 dhe në seancat gjyqësore, respektivisht në shqyrtimin kryesor të datës 12.04.2024 ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar dhe ta vërtetojë vendimin e Këshillit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. I njëjti shton se nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë i sëmurë me COVID 19, ngase këtë e kemi konstatuar edhe në vendimin e kontestuar, mirëpo kontestuese janë të gjitha veprimet që paditësi ka bërë në rastin konkret. Bazuar në të gjitha provat, konstatohet fakti se paditësi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda disiplinore, e të cilat sanksionohen në bazë të ligjit numër 06/L-114 Për Zyrarët Publikë. I njëjti shton se, rezulton fakti se paditësi i ka marrë disa lëndë në shtëpi dhe fare nuk i ka kthyer dhe përderisa është iniciuar procedurë disiplinore kundër tij, rezulton që paditësi i ka kaluar të gjitha afatet, ashtu që sipas deklarimeve të paditësit, i njëjti lëndët i ka sjellë përmes një personi tjetër duke i lënë në hyrje të Ministrisë. Bazuar në të gjitha komunikimet, paditësi deklaroi që bizneseve për të cilat lëndët i ka marrë në shtëpi i'u ka marrë borxhe për të kryer këtë punë dhe i njëjti viktimizohet para mbikëqyrësit të drejtpërdrejt. I njëjti thekson se për shkelje të

rënda nuk mund të shqiptohen vërejtjet me shkrim apo me gojë. Po ashtu shton se, nuk qëndron pretendimi se veprimet e Ministrisë karshi me paditësin kanë qenë tendencioze dhe janë bërë kur i njëjti nuk ka qenë në vendin e punës. I njëjti deklaroi se nuk është vërejtur ndonjë diskriminim apo tendencë, përkundrazi disa herë i është kërkuar që ti sjellë lëndët në Ministri, por nuk i ka sjellë, deri në kohën kur rasti ka qenë duke u shqyrtuar në Komisionin Disiplinor. Gjithashtu e ka kundërshtuar edhe Ekspertizën financiare, për arsye se ka konsideruar se ka bazë të mjaftueshme juridike që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

E paditura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në përgjigjen në padi të datës 09.01.2024, si dhe në parashtrësën për deklaram për seancën e datës 12.04.2024, ka theksuar se, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke shtuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe në mënyrë të drejtë. I propozon gjykatës që ta refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 12.04.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Shkresa nga e paditura MTI mbi menaxhimin e procesit të licencave në Departamentin për Rregullimin në Tregun e Naftës me numër 8639 i dt.19.11.2020; Vendimi i të paditurës KPMSHCK Nr.151/2021 i dt.28.04.2021; Ankesa e parashtruar nga paditësi tek e paditura KPMSHCK e dt.18.03.2021; Vendimi i lëshuar nga MTI me numër protokollit 8744 i dt.25.11.2020; Akt Emërimi në emër të paditësit ... i datës 19.09.2019; Fletëparaqitja e lëshuar nga e paditura MTI në emër të paditësit me numër protokollit 8466 e dt.11.11.2022; Email-et zyrtare të shkëmbyera të datës 05.11.2020 ora 16:06 min. 12:45 min., ora 13:16 min., 13:41 min., 13:46 min.; Email-i i datës 10.05.2020 i orës 14:15 min., 17:04 min.; Procesverbali për lëndët e humbura e përpiluar nga ... i dt.11.11.2020; Email-et zyrtare për pranimin e vendimit të Komisionit Disiplinor i dt.25.11.2020 në ora 12:00, Email-i i datës 19.12.2020 në ora 14:50 dhe 11:45 minuta; Procesverbali i seancës së dytë të Komisionit Disiplinor nga MTI i datës 19.12.2020; Procesverbali i datës 23.11.2020 në ora 11:30 min.; Procesverbali i datës 25.11.2020; Procesverbali i datës 16.11.2020; emali zyrtarë nga ... e datës 25.11.2020; emali nga ... i datës 23.11.2020 në ora 12:04 min. Dhe ora 12:01minuta, emali i datës 23.11.2020 nga ... në ora 13:08 minuta, Emali i datës 23.11.2020 në ora 13:19 min. Nga ...; Raporti i prezencës në punë, për periudhën 18.05.2020, 16.05.2020 për paditësin e lëshuar me datën 16.11.2020; emali zyrtar nga paditësi i datës 16.12.2020; Emali i datës 04.11.2020 nga paditësi; emali zyrtar nga paditësi i datës 12.10.2020; emali zyrtar i datës 21.07.2020, i datës 18.06.2020, i datës 11.06.2020; Emali i datës 11.09.2020 nga Paditësi ...; Vendimi i lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit Sanitar i datës 16.07.200; Kërkesa për pushim nga paditësi i datës 07.09.2020; Kërkesa për pushim vjetor e datës 24.08.2020 nga paditësi; Kërkesa për pushim e datës 12.06.2020; Vendimi në emër të paditësit nga Drejtoria e Inspektionit Sanitar me numër 14/783 e datës 05.10.2020 Komuna e Gjilanit; Shkresa për procedurën e licencimit (nuk identifikohet data); Kërkesa për mbledhjen

fillestare nga auditimi i brendshëm i datës 10.11.2020; Pasqyra bankare nga NLB Banka nga ... për periudhën 01.01.2019 deri me datën 16.02.2024; Lista e pagave nga Buxheti i R.Kosovës me Kod 10-49100-204-0432 për paditësin ... si dhe Ekspertiza financiare e datës 22.02.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 të Ligjit për Konflike Administrative ashtu që vendosi që vetë meritonisht ta vendosë këtë çështje administrative.

Gjykata duke vlerësuar vendimet e goditura me padi dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, thënieve në padi dhe përgjigjet në padi të të paditurave dhe deklarimeve në seancat e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës së kësaj çështje administrative, konstatoi se padia e paditësit është e pabazuar.

Pas administrimit të provave të lartcekura, lidhur me vendimet e kontestuara nga paditësi dhe pas vlerësimit të tyre me kujdes - si tërësi e provave, dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, gjykata i fali besimin pretendimeve të të paditurave, sepse gjykata vlerëson se këto vendime qëndrojnë në harmoni me kërkesat ligjore në fuqi dhe se mbështeten me prova relevante për një vendosje të tillë.

Me vendimin e datës 25.11.2020 me numër protokollit 8744 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nëpunësit civil, këtu paditësit ... – ..., i shqiptohet masa disiplinore “Largim nga Shërbim Civil” pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension, me arsyetimin se i njëjti ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Kundër këtij vendimi, këtu paditësi ... ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 18.03.2021.

Me vendimin e datës 28.04.2021 me numër A.nr.151/2021, Këshilli I Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e lartcekur të ankuesit, këtu paditësit ..., ndërsa ka lënë në fuqi vendimin me numër protokollit 8744 të datës 25.11.2020 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Kundër vendimit të lartcekur me numër A.nr.151/2021 të datës 28.04.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 28.05.2021, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi i'u referua dispozitave ligjore të nenit 25 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët publikë i cili përcakton se “1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e

njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike “ si dhe nenin 26 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.”, ndërsa neni 28 i këtij ligji përcakton se: ”Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”.

Gjithashtu me nenin 46 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratret Publike përcaktohet se:” 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; ku sipas paragrafit 3 Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

Gjykata nga provat e administruara në shkresat e lëndës gjeti se paditësi, ka pranuar se dokumentet zyrtare të subjekteve afariste që kanë aplikuar për licencë i ka përdorur jashtë vendit të tij të punës në mënyrë të jashtëligjshme. I njëjti i ka fshehur lëndët dhe nuk ka raportuar tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë lidhur me mos tërheqjen me kohë të licencave konform afateve ligjore nga ana e subjekteve ekonomike. Më tutje, Paditësi ka pranuar se lëndët në Ministri i ka sjellë një person që nuk është as punëtor i Ministrisë, i njëjti me deklaratimet e tij ka pohuar se me disa prej subjekteve afariste, janë shokë të shtëpisë, ndërsa ka deklaruar se Kompania Fer i ka ndihmuar për shkak të halleve që ka pasur me qëllim që në momentin që bëhet lënda duhet me i ndihmuar, po ashtu ka deklaruar se këtyre kompanive ju ka marrë borxh për kryerjen e punëve, rrjedhimisht të gjitha këto i ka pranuar vetë paditësi gjatë komunikimeve me udhëheqësin e tij dhe gjithashtu pranë Komisionit Disiplinor. Për të gjitha këto shkelje të detyrave të punës, paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të argumentojë pafajësinë e tij në procedurën disiplinore. Pra, të gjitha këto veprime janë të kundërligjshme, sipas dispozitave ligjore të lartcekura.

Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Pra, paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të argumentojë pafajësinë e tij.

Në këtë kuptim, gjykata pas administrimit të provave në shkresat e lëndës vërteton se paditësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore nga pozita që mban, duke bërë shkeljen e detyrimeve të përcaktuara me ligj, respektivisht ka bërë veprime të paligjshme. I njëjti pranë kësaj gjykate nuk i ka paraqitur fakte bindëse mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Andaj, bazuar në të gjitha rrethanat si më lartë, gjykata konstaton se masa disiplinore “largim nga shërbimi civil” e shqiptuar ndaj paditësit ..., nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me Vendimin me numër protokollit 8744 të datës 25.11.2020 është në proporcion me shkeljen e bërë nga paditësi, rrjedhimisht e paditura MTi Komisioni disiplinor si dhe vendimi i të paditurës (KPMShCK) me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit janë marr në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3. Nenin 50 paragrafi 1.2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ashtu që vendimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është në përputhje me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L—031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj edhe pretendimet e paditësit si në padi – parashtresën për rregullimin e padisë, si dhe deklaratimet në seancat gjyqësore janë të pa bazuara. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është zbatuar ligji në dëm të të njëjtit.

Në kuptim të nenit 4 të Ligjit për Konfliktet Administrative gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit përfundimtar administrativ.

Bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se i padituri Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK) drejtë ka vendosur kur ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit me numër A.nr.151/2021 të datës 18.03.2021 dhe ka lënë në fuqi vendimin me numër Protokoli 8744 të datës 25.11.2020 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Paditësi me asnjë provë nuk dëshmon pretendimet e tij, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative-juridike. Gjykata Ekspertizën Financiare të datës 22.04.2024 nuk e mori parasysh, për arsye se ka pasur bazë të mjaftueshme që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 1212/2021 data 12.04.2024

G j y q t a r e

Valbona Gjonbalaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.